



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e hënë, datë 22.12.2025, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Shtryjen e vendimmarrjes mbi konstatimin e pavlefshmërisë së licencës të shoqërisë “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k., për subjektin audio privat lokal “Saranda Ime Radio”, për shkak të përfundimit të afatit të vlefshmërisë dhe mosrinovimit të saj.
2. Lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 16, datë 17.11.2025 të vendosur ndaj shoqërisë “Digit-Alb” sh.a. **(Vendim nr. 106, datë 22.12.2025)**
3. Rinovimin e licencës të shoqërisë “Top Gold” sh.p.k., për subjektin audio privat rajonal “Radio Top Gold”, për një periudhë 7 (shtatë) vjeçare. **(Vendim nr. 107, datë 22.12.2025)**
4. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 14, datë 29.10.2025 për dënimin me gjobë, të shoqërisë “3DS&AF Entertainment” sh.p.k, për subjektin “Syri Tv”, për shkelje ligjore në përmbajtjet e transmetuara. **(Vendim nr. 108, datë 22.12.2025)**
5. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 21, datë 04.12.2025 për dënimin me gjobë, të shoqërisë “Media Vizion” sh.p.k, për subjektin “Media Vizion”, për shkelje ligjore në përmbajtjet e transmetuara. **(Vendim nr. 109, datë 22.12.2025)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 22 Dhjetor 2025